



Në mbështetje të nenit 5, paragrafi 1, nënparagrafi 1.1, pika 1.1.1, nenit 12 paragrafi 1, nënparagrafi 1.5 dhe nenit 22, paragrafi 3, të Ligjit Nr.08/L-017 për Agjencinë për Parandalimin e Korrupsionit, nenit 21 paragrafi 2 të Ligjit nr. 06/L-011, për Parandalimin e Konfliktit të Interesit në Ushtrimin e Funksionit Publik, neni 11, paragrafi 4, i Rregullores Nr. 03/20023 për Procedurat për Hetimet Administrative në Agjencinë për Parandalimin e Korrupsionit, Drejtori i Agjencisë për Parandalimin e Korrupsionit, me datë 26.04.2024, nxjerrë këtë:

## V E N D I M

- I. Mbyllet rasti APK-DPKI-06-273/24, për zyrtarin e lartë z. Faruk Rexhaj, Zëvendësues i Kryeshefit Ekzekutiv në Komisionin e Pavarur të Mediave, për shkak se nuk ka prova të mjaftueshme që e argumentojnë dyshimin e arsyeshëm për ekzistimin e konfliktit të interesit.
- II. Ky vendim është përfundimtar në procedurën administrative dhe i njëjti publikohet në uebfaqen zyrtare të Agjencisë për Parandalimin e Korrupsionit.

## A r s y e t i m

I. Rasti i hapur nën dyshimin për konflikt interesi për zyrtarin e lartë z. Faruk Rexhaj, Zëvendësues i Kryeshefit Ekzekutiv në Komisionin e Pavarur të Mediave, është trajtuar sipas procedurës së paraparë me Ligjin Nr. 06/L-011, për Parandalimin e Konfliktit të Interesit në Ushtrimin e Funksionit Publik (në vijim: Ligjit për Parandalimin e Konfliktit të Interesit).

Ky rast ka filluar të trajtohet pas një raportimi të jashtëm anonim (në vijim: raportues i rastit) në Agjencinë për Parandalimin e Korrupsionit, ku janë ngritur pretendime se ka pasur (citojmë nga kërkesa):

*"[...] vendimmarrje të ndikuara me konflikt interesi në mbledhjen e dytë të Komisionit të Pavarur të Mediave - KPM të mbajtur me 6 shkurt 2024".*

Më gjerësisht në kërkesën e raportuesit të rastit thuhet se (citojmë nga kërkesa):

*"[...]... Në këtë mbledhje, kundër praktikës së zbatimit të rregullores së punës së KPM, në piken të ndryshme janë trajtuar dhe ka pasur vendim marrje ku ka rishqyrtuar edhe Vendimin për ndalimin e kanaleve të Arena Sport. Zakonisht, sipas praktikës së përgjithshme nuk ka vendimmarrje në të ndryshme por vetëm informim apo diskutim, por atë ditë kryesuesi dhe KPM vendosen që të këtë vendimmarrje.*

*Edhe pse nga mandati i juaj ndoshta nuk mund të shqyrtohet ligjshmëria e kësaj shkelje të ligjit, kërkoj sipas mundësisë të trajtoni shkeljen e mundshme të UD Kryeshefit të Zyrës Ekzekutive, z. Rexhaj, i cili ka rekomanduar këtë vendimmarrje ndërsa në të njëjtën kohë gruaja e tij është e angazhuar në ARTMOTION, përfituese direkte nga kjo vendimmarrje.*

*Pra, fillimisht kërkoj që të shqyrtoni çastet paraprake të vendimmarrjes të cilat janë thelbësore dhe përcaktuese për këtë vendimmarrje në dem të interesit publik.*

*Pastaj, duke pasur parasysh pozitën kryesore të Kryeshefit të KPM në vendimmarrje a është në rregull që z. Rexhaj të ushtroj këtë pozitë duke pasur interes direkt në bizneset që i licencën (psh ARTMOTION). E pa ashtu, a ka shkel ligjin KPM kur e ka emëruar këtë person si UD duke e ditur që ka familjar në bizneset që i licencën ky institucion.[...]*

Pas pranimit të informatës si më lartë, Agjencia për Parandalimin e Korrupsionit, në pajtim me nenin 22, paragrafin 3, dhe 5 të Ligjit për Parandalimin e Konfliktit të Interesit, i ka dërguar shkresën zyrtare APK-DPKI-06-444/24 zyrtarit të lartë në fjalë, duke e njoftuar atë për fillimin e procedurës së shqyrtimit të gjendjes së mundshme të konfliktit të interesit dhe njëkohësisht i ka kërkuar dokumentacion plotësues relevant lidhur me rastin në procedurë. Duke vepruar sipas kërkesës së Agjencisë, z. Rexhaj ka dërguar informatat, sqarimet dhe dokumentacionin përkatës lidhur me rastin në fjalë.

Nga informacioni dhe dokumentacioni i pranuar nga z. Faruk Rexhaj sipas kërkesës së Agjencisë për Parandalimin e Korrupsionit, rezultojnë gjendja faktike si në vijim:

Në parashtrësën (email-en) sqaruese të z. Rexhaj fillimisht theksohet se (citoj): *“Ashtu siç ju kam njoftuar edhe në komunikimin përmes telefoni që kishim me herët, ju njoftoj edhe njëherë se me të marr pozitën zv. të Kryeshefit Ekzekutiv të KPM-së, kam parashtruar pyetje në institucionin tuaj<sup>1</sup> rreth asaj se a mund të kem konflikt interesi duke ushtruar këtë pozitë ndërsa ne të njëjtën kohë bashkëshortja ime punon në Artmotion si agjente e shitjes. Po ashtu me lejon të ju njoftoj se bashkëshortja ime në ARTMOTION ne të njëjtën pozitë ka qenë e punësuar edhe me herët, konkretisht që 3 vite, para se unë të marr pozitën e zv. të Kryeshefit Ekzekutiv të KPM-së”.*

Ndërsa, *“Sa i përket vendimit të datës 6 shkurt të vitit 2024, me lejon të ju njoftoj se me këtë vendim është shfuqizuar një vendim i marr me herët, me të cilin është bërë ndalimin e kanaleve ARENA SPORT ne të gjitha platformat kabllorë në Republikën e Kosovës. Këtu nuk behet fjalë vetëm për një operator Kabllor, mirëpo me këtë vendim i është lejuar transmetimi i kanaleve ARENA SPORT të gjithë operatoreve që transmetojnë në Republikën e Kosovës, (Artmotion, MTS, Kujtesa Net, Telkos, Ipko etj)”;*

Tutje i njëjti thekson se: *“Ne çdo takim të KPM-së, si zëvendësues i Kryeshefit Ekzekutiv i njoftoj anëtarët e KPM-së lidhur me ankesat e pranuar në KPM, kërkesat për rishqyrtim dhe me rezultatet e monitorimit të rasteve të caktuara nga ana e departamenteve që funksionojnë brenda zyrës Ekzekutive të KPM-së”;*

Në vazhdim, z. Rexhaj sqaron funksionet dhe shtyllat e KPM-së duke shtuar se:

*“KPM ka tri shtylla me të cilat funksionon: Zyrën Ekzekutive të cilën e menaxhon Kryeshefi Ekzekutiv (Pa të drejtë vote në vendimmarrje), komisionin që përbehet nga 7 anëtar dhe*

<sup>1</sup> Agjencia për Parandalimin e Korrupsionit, sa i përket faktit që bashkëshortja e z. Faruk Rexhaj punon në kompaninë ‘Artmotion’, me kërkesën e z. Rexhaj, atëherë Agjencia kundër Korrupsionit kishte nxjerrë Përgjigjen AKK-DPKI-06-1714/21, ku kishte konstatuar se: *“Ligji për Parandalimin e Konfliktit të Interesit nuk parashihet ndonjë ndalesë sa i përket situatës së përshkruar nga ana e tuaj, megjithatë i njëjti ligj ka përcaktuar disa veprime të ndaluara për zyrtarin, të cilat gjithnjë duhet të kënen parasysh, gjatë ushtrimit të funksionit publik”.*

zgjidhet drejtpërdrejt nga Kuvendi i Republikës së Kosovës (te njëjtit në kompetencën e tyre kanë vendimmarrjen) dhe bordin e ankesave që përbehet nga tre anëtar po ashtu te zgjedhur nga Kuvendi i Republikës së Kosovës (Trajtojnë ankesat ndaj vendimeve të komisionit).

Për te qen me korrekt po ashtu po e përshkruaj edhe nenin 16 te ligjit te KPM-së.

#### Neni 16 Funksionet e Zyrës Ekzekutive

1. Në kuadër të KPM-së funksionon Zyra Ekzekutive e cila ndihmon Komisionin në realizimin e detyrave dhe përgjegjësi të KPM-së;
2. Zyra Ekzekutive udhëhiqet nga Kryeshefi Ekzekutiv i cili i përgjigjet drejtpërdrejtë KPM-së dhe Kryetarit;
3. Kryeshefi Ekzekutiv dhe nëpunësit e Zyrës Ekzekutive janë nëpunës civil;
4. Nën drejtimin e Kryeshefit, Zyra Ekzekutive duhet të zbatojë të gjitha detyrat dhe përgjegjësitë e përcaktuara nga KPM-ja brenda kornizës së buxhetit të caktuar në pajtim me këtë ligj;

[...]

Në Procesverbalin e mbledhjes së dytë të komisionit të pavarur të mediave (kpm-t 2024/02), në vazhdim të raportimit të tij, z. Rexhaj në cilësinë e zv. Kryeshefit të KPM-së, shton se (citojmë): “[...] ne kemi pranuar vazhdimisht kërkesa për rishqyrtim të kanaleve Arena Sport, kemi pranuar kërkesa të reja nga ana e Arena Sport dhe operatorët e shpërndarjes. Poashtu kemi marr garanci edhe nga vet Arena Sport që përmbajtje të tilla nuk do përsëriten në të ardhmen, unë mendoj që duke pasur parasysh rrethanat që jemi aktualisht mendoj që është në interes të publikut që vendimi i KPM-se që është marr me datën 3 tetor 2023 të rishikohet nga ana e KPM-së, dhe gjithmonë në interes të publikut t'i mundësohet qasje kryesisht e ligave sportive që transmetojnë këto kanale, është obligim ligjor i KPM-së që ta trajtoj çdo kërkesë për rishqyrtim të vendimeve të saj dhe po ashtu Arena Sport ka kërkuar falje për përmbajtjet e tilla dhe është zotuar se nuk do të ketë më aso lloj përmbajtje në të ardhmen”.

Më pas, në përgjigje të raportimit të z. Rexhaj, kryetari i Komisionit J.M. shton se (citojmë): “[...] në lidhje me këtë çështje tha se vendimi për ndalimin e kanaleve të Arena Sport është marr me datën 3 tetor 2023, dhe kjo për shkak të rrethanave në të cilat ka ndodhur që në kanalet sportive të transmetohen mesazhe politike e që kanë qenë në kundërshtim me rregulloret e KPM-së dhe në këtë aspekt KPM-ja e ka parë të udhës që të bëjë pezullimin të menjëhershëm të kanaleve për të evituar çfarëdo eskalimi apo ndikimi të situatës që është gjendur Kosova në ato ditë. Po ashtu në vendimin tonë kemi thënë që vendimi do jetë në fuqi deri në një vendim tjetër të KPM-së dhe ky vendim për pezullim të kanaleve ka hyrë në fuqi dhe është respektuar në plotni nga ana e operatorëve. Ka pasur kërkesa të disahershme nga Arena direkt dhe nga operatorët që kanë pasur të drejtën e transmetimit të këtyre kanaleve sportive që KPM-ja të rishqyrtojë vendimin e vet sepse rrethanat kanë ndryshuar dhe vendimi jone për një kohë të gjatë i ka pamundësuar një komuniteti të caktuar të ketë qasje në disa të drejta sportive duke ofruar një garanci që kanë krijuar mekanizma që mesazhe të tilla politike nuk do përsëriten asnjëherë në emisione sportive. KPM-ja e gëzon të drejtën që të merr vendime të menjëhershme kur e sheh që kanalet e huaja që ritransmetohen në Kosovë përmes operatorëve të shpërndarjes janë në kundërshtim me

rregulloret e KPM-së. E hapim diskutimin për këtë çështje.[...] Nga ajo çfarë po kuptoj nga diskutimi dhe ngritja e çështjes nga zyra ekzekutive, kanë ndryshuar rrethanat dhe në të njëjtën kohë ne ruajmë të drejtën tonë që në të ardhmen nëse ka shkelje të tilla mund të marrim masa më të drejtpërdrejta, dhe nga disponimi që po e shoh edhe nga anëtarët e Komisionit rekomandoj që të hidhet në votim shfuqizimi i vendimit të datës 3 tetor dhe të bëhet një vendim i ri me masat që u përmenden dhe paralajmërimit për largim të përhershëm në rast se përsëritet e njëjta shkelje. Kryetari hodhi në votim shfuqizimin e vendimit të datës 3 tetor 2023, në të cilën i kemi pezulluar kanalet sportive të Arena Sport dhe përpilimit të një vendimi të ri ku parashihen masat e reja që të mos përsëritet incidenti i njëjtë. Komisioni votuan me 4 vota për”.

Mëpas, me vendimin e datës 20 mars 2024 (Ref: 2403/399/KPM), Komisioni i Pavarur i Mediave merr vendim ku përmes dispozitivit vijues:

*“I. OBLIGOHET operatori i shpërndarjes ARTMOTION që menjëherë ti largojë nga transmetimi kanalet ARENA SPORT, me qëllim të respektimit dhe parandalimit të cenimit të të drejtave të transmetimit për ligat sportive, të cilat transmetohen përmes kanaleve Arena Sport në territorin e Republikës së Kosovës;*

*II. Udhëzohet Zyra Ekzekutive e KPM-së të fillojë një proces të verifikimit administrativ të zinxhirit të të drejtave të transmetimit për të gjitha ligat sportive të transmetuara nga ana e kanaleve Arena përmes operatorëve të shpërndarjes në territorin e Republikës së Kosovës;*

*III. Ky vendim mbetet në fuqi deri atëherë kur KPM sigurohet se ARENA SPORT” respekton të gjitha rregulloret e KPM-së dhe ligjet e Republikës së Kosovës.*

Duke u bazuar në gjendjen faktike të konstatuar më sipër, Agjencia për Parandalimin e Korrupsionit, në cilësi të autoritetit qendror për zbatimin e Ligjit për Parandalimin e Konfliktit të Interesit, ju njofton si në vijim:

Fillimisht, me nenin 6 të Ligjit për Parandalimin e Konfliktit të Interesit është përkufizuar nocioni i konfliktit të interesit, ashtu që:

*“Konflikti i interesit lind nga një rrethanë në të cilën zyrtari ka interes privat, që ndikon, mund të ndikojë ose duket se ndikon në kryerjen me paanshmëri dhe objektivitet të detyrës së tij zyrtare”.*

Ndërsa me dispozitën e nenit 17 [Deklarimi rast për rast i interesave private të zyrtarit], paragrafi 1 të Ligjit për Parandalimin e Konfliktit të Interesit është përcaktuar se:

*“1. Çdo zyrtar gjatë ushtrimit të funksionit të tij publik, në bazë të njohurive të tij dhe në mirëbesim, detyrohet që të bëjë vetëdeklarimin paraprak, rast për rast, të ekzistencës së interesit të tij privat ose të personave të afërm me të lidhur me vendimmarrjen në një çështje të caktuar, që mund të bëhet shkak për lindjen e një konflikti të interesit dhe të tërhiqet nga kjo vendimmarrje.”*

... lidhur me nenin 3 paragrafi 1, nënparagrafi 1.2 të Ligjit për Parandalimin e Konfliktit të Interesit, me të cilin është përkufizuar se:

*“Interesi privat i personit zyrtar - nënkupton çfarëdo përparësie për personin zyrtar, familjen e tij, të afërmit, miqtë dhe personat apo organizatat me të cilat ai ka pasur apo ka marrëdhënie afariste”.*

si dhe me nën-paragrafin 1.6 të këtij nenin me të cilin është përkufizuar se:

*“person i afërm me zyrtarin është - bashkëshorti ose personi që bashkëjeton, të afërmit në vijë të drejtë të gjakut pa kufizime, të afërmit në vijë të tërthortë deri në shkallën e katërt, adoptuesi, i adoptuari, i afërmi në gjini të krushqisë deri në shkallën e dytë si dhe çdo person fizik apo juridik i cili ka pasur ose ka një lidhje të përbashkët interesi privat pasuror ose jopasuror me zyrtarin.*

Ndërsa dispozita e nenit 3, paragrafi 1, nënparagrafi 1.12 të Ligjit për Parandalimin e Konfliktit të Interesit, e definon nocionin vendimmarrje si:

*“Çasti i fundit i procesit vendimmarrës gjatë të cilit vendoset përmbajtja përfundimtare e aktit apo kontratës si dhe ato çaste paraprake të vendimmarrjes të cilat janë thelbësore dhe përcaktuese në të cilat pjesëmarrja, ndikimi dhe qëndrimi i zyrtarit përcaktojnë përmbajtjen përfundimtare të aktit apo kontratës si dhe çdo veprim i zyrtarit në ushtrimin e funksionit publik.”*

Konflikti i interesit është i lidhur ngushtë me vendimmarrjen dhe/apo çastet paraprake të vendimmarrjes lidhur me ekzistencën e interesit privat të zyrtarit ose të personave të afërm në një çështje të caktuar, e që lidhur me pretendimet e ngritura nga raportuesi i rastit për konflikt të interesit, nuk është gjetur që në kuptim të dispozitave të sipërcituara të jetë plotësuar njëri nga kushtet kumulative, siç është vendimmarrja apo çastet paraprake të vendimmarrjes në çështjen konkrete.

Pra, nga verifikimet e Agjencisë për Parandalimin e Korrupsionit, nuk është gjetur që në kuptim të dispozitave të sipërcituara, z. Faruk Rexhaj të ketë qenë pjesë e vendimmarrjes apo çasteve paraprake të vendimmarrjes lidhur me pretendimet e ngritura nga raportuesi i rastit, prandaj në rastet kur mungon vendimmarrja apo çastet paraprake të vendimmarrjes nga zyrtari (si kusht i domosdoshëm kumulativ), përjashtohet konflikti i interesit sipas dispozitave të Ligjit për Parandalimin e Konfliktit të Interesit.

Raportimi i z. Rexhaj në takimin e Komisionit të Pavarur të Mediave (si pjese e përgjegjësisë së tij) nuk ka mundur të jetë as thelbësor e as përcaktues, e aq më pak ndikues sa i përket vendimmarrjes nga anëtarët e Komisionit, pasi që ushtrimi i ndikimit në një vendimmarrje të caktuar, në kuptim të dispozitave të nenit 16 të Ligjit për Parandalimin e Konfliktit të Interesit, ekziston atëherë kur eprori apo mbikëqyrësi ushtron ndikim në vartësin e tij dhe jo anasjelltas, çfarë flet edhe fakti që, të njëjtit (anëtarët e KPM-së) për një kohë relativisht të shkurtër kanë marr dy vendime të ndryshme për çështjen e kanaleve 'ARENA SPORT'.

Prandaj, Agjencia për Parandalimin e Korrupsionit, pas shqyrtimit të informacionit dhe dokumentacionit në dispozicion, duke u bazuar në dispozitat e Ligjit për Parandalimin e Konfliktit të Interesit, konstatoi se nuk ka prova të mjaftueshme që e argumentojnë dyshimin e arsyeshëm për ekzistimin e konfliktit të interesit lidhur me rastin e raportuar.

II. Agjencia vendosi si në pikën III, të dispozitivit të këtij vendimi, duke u bazuar në nenin 22 [Procedura administrative e Agjencisë për rastet e konfliktit të interesit], paragrafi 12 të Ligjit për Parandalimin e Konfliktit të Interesit, me të cilin është përcaktuar se: *“Të gjitha vendimet*

*që i nxjerr Agjencia lidhur me konfliktin e interesit në ushtrimin e funksionit publik dhe shkeljen e dispozitave të këtij ligji, përfshirë veprimet e ndaluara ose të kufizuara në ushtrimin e funksionit publik, ushtrimin e veprimtarive të tjera, papajtueshmëritë në ushtrimin e funksionit publik, duhet të respektohen nga zyrtarët dhe institucionet përgjegjëse. Ato bëhen publike në faqen zyrtare të internetit të Agjencisë.”, si dhe paragrafin 15 të këtij neni, me të cilin është përcaktuar se: “Vendimet e Agjencisë në lidhje me konfliktin e interesit janë përfundimtare në procedurë administrative.”*

Nga sa u tha më lartë, u vendos si në dispozitiv të këtij vendimi.

Vendimi iu dërgohet:

- Zyrtarit të lartë publik
- Drejtorit të DPKI- së
- Z./znj. (zyrtari përgjegjës)

Yll BULESHKAI  
Drejtor i Agjencisë për  
Parandalimin e Korrupsionit